



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

**KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR SHERBIME**  
(ME NJË OPERATOR EKONOMIK)

**KOMUNA E ISTOGUT, Njesia e Prokurimit te cilën e përfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z-nja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga “Fadil Ferati” nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, ne cilësinë e porositesit te sherbimeve të Autoritetit Kontraktues në njërën anë;**

**dhe**

**KONZORCIUMI “PMN” SHPK & NPN “UNIVERS-MI” nga Prishtina, Komuna e Prishtinës, me Nr. Rexhistrimit te biznesit: 70631342, përkatësisht 70907674 të cilin e përfaqëson, z. Zenun Tolaj, ne cilësnë e “kryersi i shërbimeve”, në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet si më poshtë:**

**MBIKQYRJA E PROJEKTEVE KAPITALE**

<b>Nr. I prokurimit</b>	<b>633-19 – 436 -2-2-1/ FA/036</b>
<b>Nr. I brendshëm</b>	<b>633 / 019/ 002-2-2-1</b>

**Neni 1 Lënda**

**1.1Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për shërbimet si në vijim: **Mbikqyrja e projekteve kapitale**, si dhe kryerja e shërbimeve ndihmëse nga ofruesi I shërbimeve siq është përcaktuar në dosjën e tenderit.**

**MBIKQYRJA E PROJEKTEVE KAPITALE**

Specifikimi i detyrueshem teknik dhe fomulari i çmimeve i datës 07. 03. 2019 është pjesë përberese e kontratës dhe e njëjti është bazë për pagesen e kontraktorit.

~~Autoriteti Kontraktues bënë kryerjen e shërbimeve veçanërisht në emër të Autoritetit~~

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të kryej në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek kryersi I shërbimeve, **duke specifikuar listën me projektet perkatëse.**

1.3 Kontrata hynë në fuqi më NËNSHKRIMIN E SAJË PËRKATËSISHT ME DATË 23.05.2019 DHE DO TË PERFUNDOJË ME SË LARTI DERI ME 22.05.2022 PASI KONTRAKTORI TE SJELLË DESHMINË MBI SIGURINË PER EKZEKUTIMIN E KONTRATËS ME VLEFSHMËRI PREJ 37 MUAJVE, NGA DATA E NËNSHKRIMIT TË KONTRATËS.

## Neni 2 Koha e perfundimit

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjen e te gjitha SHËRBIMEVE do të jetë: **22.05.2022** si afat I skadimit te afatit te kontratës.

2.2 Vendi i kryerjës së shërbimeve do të jenë **KOMUNA E ISTOGUT –**

2.3. Obligimet e kontraktorit (kryerist te shërbimit) janë të gjitha shërbimet të percaktuara ne Nenin 2.1 e dosjes së tenderit dhe kushteve te pergjithshme dhe te veqanta te kontratës.

2.4 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

2.5 Kontrata mund te shkëputet edhe para këtijë mund te shkëputet edhe para ketijëafati, po qe se kontrata permbushe me çmim sipas dispozitave te Nenit 56.10 te Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

## Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i kësajë kontrate është: 41.400,00

Vlera totale **36 Muajshe** kontratës është: **41,400,00 Euro.**

**Dhe me shkronja: /Dyzetenjëmijëkatërçindeuro/**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kontraktorit sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

## **Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

*Plani per menaxhimin e kontrates*

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## **Neni 5 Komunikimet**

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tijë.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë

miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.





5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [Shqipe] 2 në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin

**Për Autoritetin Kontraktues:**

**Komuna e Istogut**

**Për Kontraktuesin:**

**“PMN” & NPN “UNIVERS-MI”**

<b>Emri:</b>	<i>Zizë Bujupaj</i>	<b>Emri:</b>	<i>Zenun Tolaj</i>
<b>Pozita:</b>	<i>Zyrtar përgjegjës i Prokurimit</i>	<b>Pozita:</b>	<i>M e n a x h e r</i>
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	<i>23.5.2019</i>	<b>Data:</b>	<i>23.05.2019</i>
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

## **Aneksi 1.**

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të projekteve Mbikëqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet :

1. Të mbikëqyrë Kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Komunës së Istogut dhe të kryejë të gjitha detyrimet e besuara atij sipas Kontratës së nënshkruar, dhe Ligjeve aktuale
2. Të njihet në detaj me projekt zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit , të hartoj programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve në bazë të standardeve dhe ligjeve në fuqi.
3. Të paraqesë pranë Komunës së Istogut stafin e tij mbikëqyrës .
4. Drejtuesin e punimeve, që duhet të jete inxhinier ndërtimi ose arkitekt me eksperience pune në mbikëqyrje i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, certifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, korrespondencën me Komunën e Istogut, cilësinë e punimeve etj.
5. Mbikëqyrësin për punime arkitektonike që duhet të jetë arkitekt me eksperiencë pune në këtë fushë i cili miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve.
6. Mbikëqyrësin për punimet elektrike që duhet të jetë inxhinier elektrik me eksperiencë pune dhe stafin tjetër për punime( inxhinieret përkatës të drejtimeve të kërkuara sipas kriterëve në dosje të tenderit).
7. Të kontrolloj certifikatat e cilësisë së materialeve dhe të jap miratimin për vendosjen në objekt të tyre , gjatë zbatimit të projektit, i jep instruksione me shkrim OE, sa herë që e sheh të nevojshme, dhe OP është i detyruar t'i zbatojë ato. Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në Projekte dhe paramase të parashikuara, Mbikëqyrësi i Punimeve duhet t'i paraqesë relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse) ku argumentohet ndryshimi .Ndryshimi në objekt (zbatimi i punimeve) do të bëhet vetëm pas miratimit nga Komuna e Istogut, të nënshkruaj aktin përfundimtar të kontrollit të punimeve për faza të ndryshme .
8. Në çdo fund muaji mbikëqyrësi ka për detyrë të paraqes pranë AK raport mujor të punimeve. Në këtë raport duhet të tregohet për avancimit të punimeve dhe të pagesave të kryera. Raporti Mujor do të ketë këtë përshkrim të Punimeve që janë kryer gjatë muajit , fotografi të proceseve të punëve të kryera , situacionet mujore. Raporti Mujor do t'i dorëzohet Drejtorive përkatëse dhe do t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të saj.
9. Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe korrespondencën, urdhëratë e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që e kanë diktuar këto ndërprerje.
10. Mbikëqyrësi ka të drejtë : Të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantierit ose të punëtorëve të veçantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë. Të pezullojë punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun.
11. Të mos lejoj vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe të zëvendësoj ato me materiale të tjera nga OE me shpenzimet e tij, të kërkojë certifikatat e cilësisë ,të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të OE, në rast se materialet e

përdorura nuk miratohen nga mbikëqyrësi këto duhet të dokumentohen me procesverbalet e analizave.

12. Të kërkojë kryerjen e provave shtesë për materialet e vendosura në objekt, kur këto nuk janë kryer në masën sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesë së lëndës së parë të furnizuar për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të OE.
13. Kur Mbikëqyrësi i Punimeve mendon se ka dëmtime në konstruksion, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të OE.
14. Mbikëqyrësi i Punimeve urdhëron OE të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij, punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në Projekt dhe Specifikimet Teknike.
15. Mbikëqyrësi i Punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet, për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, për çdo rast me miratimin e AK, për aq kohë sa ai e konsideron të arsyeshme.
16. Te ketë takime të rregullta me Drejtoret e njëjësive kërkuese në lidhje me progresin e punimeve, pengesat eventuale gjatë punës si dhe mbarëvajtjen e realizimit të projektit përkatës.
17. Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe një kopje të kompletuar të dorëzon te AK.

• Gjatë këtij viti do të mbikëqyren:

1. Kanalizime
2. Ujësjellës
3. Rrugë
4. Kanale të vaditjes
5. Rregullime të lumenjve
6. Terrene sportive
7. Nxemje qendrore
8. Ndërtime të ambulanteve
9. Renovimi i shkollave
10. Ndriçime publike, Mirëmbajtje dhe renovim
11. Ndërtimi rrethojave të shkollave
12. Ndërtimi i trotuareve dhe renovimi apo mirëmbajtja e tyre
13. Renovime (mirëmbajtja) të rrugëve të asfaltuara, sanimi i gropave
14. Ndërtimi i urave dhe tombinave
15. Dhe projekte tjera kapitale të natyrave të ngjashme të cilat nuk janë përfshirë në këtë Listë

Indikacion për ndryshimin e datës së fillimit dorëzimit të sasisë	
Fillimi	Shëno datën
Dorëzimi	Shëno datën

Informacione (shënime) të detajuara mund të sigurohen në qendrën e zakonshme shërbimesh të ndërtimit dhe sasia për realizimin e tyre.

Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është [shëno përqindjen].

### PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

~~Udhëzime për plotësimin e kësaj janë dhënë sipas nevojës në shënimet kushtive të përmendura në nenet përkatëse të KPK. Eshtë ato që relevante.~~

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Neni	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: <b>GJUHA SHQIPE</b>
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është: <b>DREJTORATI I ZHVILLIMIT EKONOMIK.</b>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është: <b>10% E VLERES SE KONTRATES, ME VLEFSHMERI 37 MUAJ.</b>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim Pajisjeve shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar  e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Periudha e përgjegjësisë së Defekteve është <span style="background-color: black; color: black;">XXXXXXXXXX</span>
Zgjidhja miqësore e	20.2	<del>Specialitësi dhe procedurat për zgjidhjen miqësore të</del>

mosmarrëveshjes		
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë</b> në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <del>specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes në pajtim me specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregutë Komerciale e Kosovës e Bashkëzotë, mbi ligjin e Tregutë Ndërkombëtare, apo procedura të tjerë të arbitrazhit të palëve ndërkombëtare).</del></p>